

**SISTEMI I PENSIONEVE NË SHQIPËRI:
ROLI KOMPLEMENTAR I PENSIONEVE PUBLIKE DHE
PRIVATE**

Klaudia Lipi¹, Kostanca Ngjela², Silvana Çuka³

¹Universiteti “Fan S. Noli”, Fakulteti i Ekonomisë , Shëtitorja Rilindasit
Korçë,

klaudialipi@yahoo.com

²Universiteti “Fan S. Noli”, Fakulteti i Ekonomisë, Shëtitorja Rilindasit
Korçë,

kostancangjela@gmail.com

³Universiteti “Fan S. Noli”, Fakulteti i Ekonomisë , Shëtitorja Rilindasit
Korçë,

silvanacuka30@gmail.com

Abstrakt

Ky punim paraqet një analizë të detajuar të dy skemave të pensioneve në Shqipëri: skemës publike dhe asaj jopublike, duke vlerësuar qëndrueshmërinë e tyre financiare përballë sfidave demografike dhe ekonomike. Qëllimi i studimit është të krahasojë efikasitetin e skemës së detyrueshme, e bazuar në solidaritetin ndërbrezor, me skemat vullnetare që mbështeten në kapitalizimin individual. Metodologjia e përdorur është e përzier, duke ndërthurur analizën teorike me një krahasim të avantazheve dhe disavantazheve përkatëse.

Gjetjet kryesore tregojnë se sistemi i detyrueshëm përballet me presion të lartë si pasojë e plakjes së popullsisë, emigracionit dhe nivelit të lartë të informalitetit. Në të kundërt, skemat vullnetare paraqiten si një alternativë për rritjen e kursimeve përmes interesit të përbërë, diversifikimit të rrezikut, mundësisë së trashëgimisë dhe përfitimeve tatimore.

Punimi gjithashtu argumenton se mbështetja ekskluzive vetëm në njëërën skemë përbën rrezik të lartë financiar në afatgjatë. Ndaj diversifikimi i burimeve përmes përdorimit të të dyja formave të pensioneve që ofron sistemi do të garantonte standart jetese të qëndrueshëm për çdo individ dhe shoqërinë në tërësi.

Fjalë kyçe: *mirëqenie, kapitalizim, demografi, raport varësie, kursime, defiçit.*

PENSION SYSTEM IN ALBANIA: THE COMPLEMENTARY ROLE OF PUBLIC AND PRIVATE PENSIONS

Abstract

This paper provides a detailed analysis of two pension schemes in Albania: the public and the non-public scheme, assessing their financial sustainability in the face of demographic and economic challenges. The aim of the research is to compare the efficiency of the mandatory scheme, based on intergenerational solidarity, with the voluntary schemes based on individual capitalization. The methodology of the study is mixed, combining theoretical analysis with a comparative analysis of the respective advantages and disadvantages.

The main findings highlight that the mandatory system is under high pressure from population aging, emigration and informality. In stark contrast, voluntary schemes are presented as an opportunity for increasing value through compound interest, risk diversification, inheritance freedom and tax incentives.

The paper also argues that exclusive reliance on only one scheme poses a high financial risk in the long term. Therefore, diversifying resources through the use of both forms of pensions offered by the system would guarantee a sustainable standard of living for each individual and society as a whole.

Keywords: *welfare, capitalization, demographics, dependency ratio, savings, deficit.*

1. Hyrje

Sistemi pensional përbën një nga shtyllat themelore të mbrojtjes sociale në çdo vend, pasi synon të sigurojë të ardhura për individët pas përfundimit të jetës aktive në tregun e punës. Në Shqipëri, sistemi i pensioneve është ndërtuar kryesisht mbi një skemë publike të detyrueshme, e administruar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, dhe mbështetet në parimin e solidaritetit ndërbrezor, ku kontributet e punonjësve aktualë përdoren për financimin e pensioneve të brezit të pensionistëve (ISSH, 2023).

Paralelisht me skemën shtetërore, vitet e fundit janë zhvilluar edhe skemat private të pensioneve, të cilat funksionojnë mbi bazën e kursimit individual dhe investimit afatgjatë të kontributeve në tregjet financiare. Këto skema administrohen nga shoqëri të licencuara dhe mbikëqyren nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Pensionet private konsiderohen si një mekanizëm plotësues i sistemit publik dhe synojnë

të rrisin sigurinë financiare të individëve në moshën e tretë (AMF, 2022).

Megjithatë, zhvillimet demografike dhe ekonomike (si plakja e popullsisë, rritja e jetëgjatësisë dhe ulja e lindshmërisë) po krijojnë sfida të konsiderueshme për qëndrueshmërinë financiare të sistemeve pensionale në shumë vende, përfshirë edhe Shqipërinë.

Literatura ekzistuese mbi reformën e pensioneve thekson se kalimi nga skemat PAYG drejt modeleve të kapitalizimit individual është i lidhur ngushtë me sfidat demografike dhe qëndrueshmërinë fiskale. Studimet tregojnë se plakja e popullsisë dhe rritja e raportit të varësisë demografike (old-age dependency ratio) reduktojnë bazën kontribuese dhe rrisin presionin mbi sistemet tradicionale, duke kërkuar reforma strukturore (World Bank, 2025; Polifakt, 2026). Në këtë kontekst, shtyllat e kapitalizimit individual janë promovuar si mekanizma për diversifikimin e burimeve të të ardhurave në pleqëri dhe reduktimin e barrës fiskale, megjithëse ndikimi i tyre mbetet i kufizuar në shumë vende për shkak të mbulimit të ulët dhe zhvillimit të pamjaftueshëm institucional (Altax, 2025). Nga ana tjetër, literatura empirike tregon se efektiviteti i reformave të tilla varet nga dizajni institucional dhe konteksti ekonomik, ku sistemet e kapitalizuara mund të përmirësojnë mirëqenien individuale, por gjithashtu përballen me rreziqe tregu dhe sfida në fazën e akumulimit (Khozrevanidze, 2022). Në të njëjtën kohë, studimet mbi Shqipërinë evidentojnë se përkeqësimi i raportit të varësisë dhe emigracioni kanë rritur nevojën për reforma të thella, pasi sistemi aktual rrezikon të ofrojë përfitime gjithnjë e më të ulëta dhe të krijojë deficite afatgjata (Xhepa, 2025).

Ndërsa studimet ndërkombëtare theksojnë po ashtu, nevojën për reforma strukturore dhe diversifikimin e burimeve të të ardhurave në pension, përmes kombinimit të skemave publike dhe private (World Bank, 2019; OECD, 2021).

1.1 Objektivat e punimit

Ky punim synon të analizojë dhe të vlerësojë funksionimin e sistemeve pensionale në Shqipëri, duke u fokusuar në karakteristikat, avantazhet dhe sfidat e skemës publike¹ dhe asaj private.

Në mënyrë më specifike, objektivat e studimit janë:

¹ Në këtë studim termi “publik” është përdorur në të njëjtin kontekst si emërtim alternativë i termit “shtetëror”.

- ✓ Të analizojë parimet dhe mënyrën e funksionimit të skemës shtetërore të pensioneve në Shqipëri, me theks në mekanizmin e solidaritetit ndërgjeneracional.
- ✓ Të shqyrtojë karakteristikat dhe rolin e skemave private të pensioneve si instrument kursimi dhe investimi afatgjatë.
- ✓ Të krahasojë avantazhet dhe kufizimet e të dyja sistemeve pensionale.
- ✓ Të vlerësojë qëndrueshmërinë e tyre financiare në kushtet e ndryshimeve demografike dhe ekonomike aktuale.

1.2 Metodologjia

Për realizimin e këtij studimi është përdorur një kornizë metodologjike e bazuar në analizën teorike dhe krahasuese të sistemeve pensionale në Shqipëri.

Metodologjia e përdorur përfshin:

Analizën teorike, e cila konsiston në shqyrtimin e literaturës dhe studimeve akademike të ndryshme, mbi modelet e pensioneve dhe rolin e tyre në sistemet e mbrojtjes sociale.

Analizën krahasuese, përmes së cilës janë analizuar dhe krahasuar, karakteristikat kryesore, avantazhet dhe disavantazhet e skemës publike dhe asaj private të pensioneve.

Analizën e të dhënave sekondare, e cila është bazuar në raportet dhe publikimet e institucioneve ndërkombëtare dhe kombëtare, si Banka Botërore, OECD, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe legjislacioni shqiptar mbi sigurimet shoqërore.

Kombinimi i këtyre metodave mundëson një analizë më të plotë dhe objektive të funksionimit dhe perspektivave të sistemeve alternative pensionale në Shqipëri.

2. Analiza e sistemit të pensioneve shtetërore (shtylla e parë)

2.1 Mekanizmi funksional: Sistemi "Pay-As-You-Go" (PAYG)

Mekanizmi operativ mbi të cilin mbështetet pjesa më e madhe e pensioneve shtetërore njihet si sistemi Pay-As-You-Go (PAYG), ose "paguaj sipas mundësisë" / "shpenzo menjëherë". Ky është një sistem transferimi i drejtpërdrejtë, ku kontributet e sigurimeve shoqërore të mbledhura nga punëmarrësit dhe punëdhënësit aktualë nuk

akumulohen në llogari individuale, por përdoren menjëherë për të financuar pensionet e brezit aktual të pensionistëve.

Logjika e këtij sistemi mbështetet në solidaritetin ndërgjeneracional. Brezi i sotëm i punonjësve financon pensionet e prindërve të tyre, me besimin se, kur ata vetë të dalin në pension, brezi pasardhës (fëmijët e tyre) do të kontribuojë për të mbuluar pensionet e tyre.

Në nivel makroekonomik, ekuilibri i këtij sistemi mund të përshkruhet përmes ekuacionit të njohur të qëndrueshmërisë:


$$C * W * N = P * R$$

Ku:

- **C (Contribution rate):** Përqindja e kontributit mbi pagën.
- **W (Average Wage):** Paga mesatare në shkallë vendi.
- **N (Number of workers):** Numri i punonjësve që kontribuojnë.
- **P (Average Pension):** Masa mesatare e pensionit që paguhet.
- **R (Number of Retirees):** Numri i pensionistëve që përfitojnë.

Që sistemi të jetë i vetëqëndrueshëm pa pasur nevojë për fonde shtesë nga buxheti i shtetit, shuma e mbledhur nga punonjësit (ana e majtë e ekuacionit) duhet të jetë e barabartë me shumën që u shpërndahet pensionistëve (ana e djathtë). Sidoqoftë, në kushtet e sotme ku raporti midis punonjësve (N) dhe pensionistëve (R) po ngushtohet vazhdimisht për shkak të plakjes së popullsisë, ky ekuilibër po bëhet gjithnjë e më i vështirë për t'u mbajtur, duke i detyruar shtetet të ndërmarrin reforma si rritja e moshës së daljes në pension ose rritja e shkallës së kontributit (C).

Figura 1: Numri i kontribuesve urbanë dhe ruralë.



Burimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore, 2025

2.2 Struktura e kontributeve dhe përfitimeve në Shqipëri

Sistemi shqiptar i sigurimeve shoqërore funksionon mbi bazën e detyrimit ligjor për çdo person ekonomikisht aktiv (të punësuar, të vetëpunësuar apo punëdhënës). Shuma e kontributit llogaritet si përqindje mbi pagën bruto, ku barra ndahet midis punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Në Shqipëri, shkalla e kontributit për degën e pensioneve është e përcaktuar qartë. Punëdhënësi paguan një përqindje më të lartë për të mbuluar rreziqet sociale të punonjësve të tij, ndërsa punëmarrësi kontribuon direkt nga paga e tij bruto.

Tabela 1: Struktura e kontributeve në Shqipëri

Lloji i Sigurimit	Punëdhënësi	Punëmarrësi	Totali
Sigurimi Shoqëror (Pensionet, etj.)	15.0%	9.5%	24.5%
Sigurimi Shëndetësor	1.7%	1.7%	3.4%
Totali i Kontributeve	16.7%	11.2%	27.9%

Burimi: ISSH, 2026

2.3 Përparësitë e sistemit publik shqiptar të pensioneve

Pavarësisht kritikave, sistemi shtetëror mbetet mbrojtja kryesore për masën e gjerë të popullsisë për disa arsye:

- **Garancia e pagimit:** Pensionet shtetërore janë të garantuara nga Kushtetuta dhe Buxheti i Shtetit. Edhe nëse Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH) ka deficit, shteti është i detyruar të plotësojë fondet nga taksat e tjera.
- **Indeksi i pensioneve:** Çdo vit, qeveria shqiptare bën indeksimin e pensioneve bazuar në normën e inflacionit të shportës së konsumit, duke u përpjekur të ruajë fuqinë blerëse të pensionistëve përballë rritjes së çmimeve.
- **Mbrojtja e shtresave në nevojë:** Përmes "Pensionit Social", shteti mbron edhe ata individë që nuk kanë arritur të plotësojnë vitet e punës, duke parandaluar varfërinë ekstreme në moshë të thyer.

2.4 Analiza e qëndrueshmërisë dhe sfidat strukturore të sistemit pensional shqiptar

Sistemi i pensioneve në Shqipëri, ndonëse ka pësuar reforma të njëpasnjëshme (me kulminacionin në reformën e vitit 2014), sot gjendet përballë një sërë sfidash komplekse që kërcënojnë balancën e tij financiare dhe aftësinë për të garantuar përfitime dinjitoze në dekadat e ardhshme. Këto sfida nuk janë thjesht administrative, por janë ngushtësisht të lidhura me transformimet demografike, ekonomike dhe sociale që po kalon shoqëria shqiptare.

2.4.1 Presioni demografik dhe plakja e popullsisë

Një nga faktorët kryesorë që destabilizon skemën *Pay-As-You-Go* është tranzicioni demografik. Shqipëria po përjeton një rënie të vazhdueshme të normës së lindshmërisë dhe një rritje të jetëgjatësisë mesatare. Kjo do të thotë se numri i individëve që hyjnë në moshën e pensionit po rritet me ritme më të shpejta sesa numri i të rinjve që hyjnë në tregun e punës. Kur baza e kontribuuesve ngushtohet ndërkohë që numri i përfituesve zgjerohet, presioni mbi fondin e sigurimeve shoqërore bëhet i papërballueshëm pa ndërhyrjen e buxhetit të shtetit.

2.4.2 Fenomeni i emigrimit dhe "Rrjedhja e kontribuesve"

Emigrimi masiv i forcës së re punëtore mbetet një plagë e hapur për

qëndrueshmërinë e pensioneve. Largimi i të rinjve nuk është vetëm një humbje e kapitalit njerëzor, por një humbje direkte e të ardhurave për skemën e sigurimeve. Ky fenomen krijon një "hendek gjeneracional", ku brezi që supozohej të financonte pensionet e prindërve të tyre, kontribuon në skemat e vendeve të tjera (si Greqia, Italia apo Gjermania), duke e lënë sistemin shqiptar me një deficit kronik.

2.4.3 Informaliteti i tregut të punës dhe evazioni i kontributeve

Një sfidë tjetër mbetet shkalla e lartë e informalitetit në ekonomi, e manifestuar kryesisht përmes:

- **Punësimi të padeklaruar:** Personat që punojnë "në të zezë" dhe nuk paguajnë asnjë kontribut.
- **Nën-deklarimit të pagave:** Praktika ku punëmarrësi regjistrohet me pagë minimale, ndërsa pjesën tjetër të pagës e merr në dorë. Kjo praktikë ka një efekt të dyfishtë negativ: së pari, privon skemën nga të ardhurat e nevojshme sot, dhe së dyti, dënon punonjësin me një pension minimal në të ardhmen, i cili nuk do të jetë i mjaftueshëm për të mbuluar koston e jetesës.

2.4.4 Raporti i varësisë së sistemit

Të gjitha këto faktorë kulmojnë në një tregues teknik të njohur si **Raporti i varësisë**. Në një ekonomi të balancuar, raporti ideal do të ishte që të paktën 3 ose 4 punonjës të financonin 1 pensionist. Në realitetin shqiptar, ky raport ka rënë në nivele alarmante (afërsisht 1.1 me 1). Kjo disbalancë e bën sistemin shtetëror të varur në masën mbi 40% nga subvencionet e drejtpërdrejta të Buxhetit të Shtetit, duke kufizuar mundësitë për rritje reale të pensioneve përtej indeksimit të thjeshtë të inflacionit

2.4.5 Raporti kontribues/pensionist

Sipas të dhënave zyrtare të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, (ISSH), për vitin 2024, Shqipëria numëron rreth **721,398 pensionistë** dhe rreth **843,867 kontribues** (të punësuar që paguajnë sigurime).

Kështu përlllogaritet raporti i varësisë $842,867/721,398 = 1.17$

Për një sistem *Pay-As-You-Go* të shëndetshëm, ky raport duhet të jetë të paktën **3 me 1**. Fakti që në Shqipëri 1.17 punonjës mbajnë 1

pensionist tregon se skema është nën presion të jashtëzakonshëm dhe nuk mund të vetëfinancohet pa ndihmën e Buxhetit të Shtetit.

2.4.6 Deficiti i skemës dhe subvencionimi

Për shkak të informalitetit dhe pagave të ulëta, paratë që mblihen nga kontributet nuk mjaftojnë. Në vitin 2024, të ardhurat nga kontributet ishin rreth 1.67 miliardë euro, ndërsa shpenzimet totale për pensionet arritën në 1.81 miliardë euro.

Deficiti: Rreth 135-140 milionë euro çdo vit mbulohen nga taksat e përgjithshme (TVSH, etj.) për të garantuar pagesat e pensioneve.

2.4.7 Reforma e pensioneve dhe rritja graduale e moshës

Që prej reformës së vitit 2015, Shqipëria po aplikon një rritje graduale të moshës së daljes në pension për të dyja gjinitë.

Situata në vitin 2025:

- Për gratë: Moshë e daljes në pension në janar 2025 është 61 vjeç e 10 muaj. Kjo moshë rritet me 2 muaj çdo vit derisa të arrijë në 63 vjeç në vitin 2032.
- Për burrat: Moshë mbetet 65 vjeç, por kërkesa për vitet e vjetërsisë në punë po rritet. Në 2025, një burrë duhet të ketë 38 vite e 8 muaj sigurime për të përfituar pension të plotë.

2.5 Paga minimale dhe maksimale -Efekti tek pensioni

Ndryshe nga sistemet ku pensioni është një shumë fikse, në Shqipëri masa e përfitimit është e lidhur ngushtë me pagën mbi të cilën janë paguar kontributet përgjatë gjithë jetës aktive. Ky proces rregullohet përmes dy kufijve kryesorë që përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM).

- **Paga minimale (2025):** Është fiksuar në **40,000 lekë**, duke vendosur kështu edhe dyshemenë e kontributit. (Qeveria ka shpallur plane për ta rritur në 50,000 lekë në vitet në vijim).
- **Paga maksimale:** Shërben si tavan. Individët që kanë paga shumë të larta paguajnë kontribute vetëm deri në këtë tavan, gjë që limiton edhe masën e pensionit të tyre të ardhshëm.

Ky sistem është i ndërtuar mbi parimin e **solidaritëtit rishpërndarës**. Duke vendosur një tavan për pagën maksimale, shteti limiton edhe masën e pensionit të lartë, duke u siguruar që fondet të përdoren më shumë për të mbështetur pensionet e ulëta dhe mesatare.

Që prej reformës së vitit 2014, llogaritja e pensionit nuk bëhet më me


skema të thjeshta, por përmes një formule që vlerëson çdo vit kontributiv. Formula bazë është:

$$PP = PB + VS * 1\% * PM$$

Ku:

- **PP (Pensioni i pleqërisë):** Shuma totale që do të përfitojë individi.
- **PB (Pensioni social/bazë):** Një vlerë e përcaktuar që u jepet të gjithëve si bazë fillestare.
- **VS (Vitet e sigurimit):** Numri total i viteve që individi ka paguar sigurime.
- **PM (Paga mesatare e vlerësuar):** Mesatarja e pagave mbi të cilat janë paguar kontributet, e indeksuar me koeficientët vjetër që shpall shteti.

Figura 2: Pensioni mesatar dhe të ardhurat mesatare (2020- 2024)



Burimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore, 2025

Shënim: Në të ardhurat janë përfshirë masa e pensionit, kompensimi për energjinë elektrike, për bukën dhe për të ardhurat minimale të pensionistëve.

Tabela 2: Pensioni Mesatar në Shqipëri (Vlerësim, 2025)

Kategoria	Vlera Mesatare (Lekë)
Pensioni urban (Qytet)	19,200 lekë
Pensioni rural (Fshat)	11,000 lekë

Pensioni social	9,200 lekë
------------------------	------------

Burimi: Përpunuar nga autorët, 2026

- **Koeficientët e indeksimit dhe fuqia blerese**

Një detaj teknik shumë i rëndësishëm është **Indeksi i pagave**. Pasi një pagë e marrë në vitin 1998 nuk ka të njëjtën vlerë me një pagë të vitit 2025, shteti aplikon koeficientë për të sjellë vlerën e pagave të vjetra në nivelin e sotëm. Pa këtë proces, pensionet do të ishin qesharake dhe nuk do të mbulonin as kërkesat minimale të jetesës

- **Hendeku midis pagës dhe pensionit (Shkalla e zëvendësimit)**

Një koncept është edhe **shkalla e zëvendësimit**. Kjo tregon se sa përqind të pagës që merrte kur ishte në punë, merr individi si pension. Në Shqipëri, ky hendek është mjaft i gjerë.

- Për pagat e ulëta, pensioni zëvendëson rreth **60-70%** të pagës.
- Për pagat e larta, për shkak të "tavanit" të pagës maksimale, pensioni mund të zëvendësojë vetëm **25-30%** të pagës.
- Në Shqipëri, kjo shkallë është rreth **35% - 45%**.

3. Sistemi i pensioneve private

3.1 Filozofia e kapitalizimit dhe "Paraja në punë"

Ndryshe nga sistemi shtetëror, i cili bazohet në transferimin e menjëhershëm të fondeve nga një gjeneratë te tjetra, sistemi i pensioneve private funksionon mbi parimin e **kapitalizimit të plotë individual**. Në këtë skemë, çdo kontribut që derdhet nga individi nuk shkon për të paguar pensionistët e sotëm, por regjistrohet në një llogari personale dhe investohet në tregjet financiare.

3.2 Stimujt tatimorë: Një avantazh strategjik i pensioneve private

Një nga faktorët kryesorë që nxit rritjen e pensioneve private në Shqipëri është politika favorizuese tatimore e ndjekur nga shteti. Për të lehtësuar barrën mbi skemën shtetërore, qeveria inkurajon qytetarët të kursejnë privatisht përmes lehtësive fiskale, të cilat janë të sanksionuara në Ligjin për Tatimin mbi të Ardhurat.

✓ **Përrjashtimi nga tatimi mbi pagën** : Kontributi që një individ derdh në një fond pensioni privat zbritet nga paga e tij bruto përpara se të llogaritet tatimi mbi të ardhurat. Kjo do të thotë se pjesa e pagës që

shkon për pension privat është "**e pataksueshme**".

Shembull: Supozojmë një individ me pagë bruto 100,000 lekë.

- **Pa pension privat:** Ai do të paguajë tatim mbi të ardhurat për të gjithë shumën që kalon kufirin e pataksueshëm.
- **Me pension privat:** Nëse ai investon 10,000 lekë në një fond pensioni, shteti do ta taksojë atë sikur paga e tij të ishte 90,000 lekë.

Përfitimi: Individu kursen 10,000 lekë për veten e tij, por paga e tij neto (ajo që merr në dorë) nuk ulet me 10,000 lekë, sepse një pjesë e kësaj shume mbulohet nga "kursimi" i taksës që nuk po i jepet shtetit.

✓ **Lehtësitë për punëdhënësin:** Nëse një kompani paguan pension privat për punonjësit e saj (si bonus), kjo shumë njihet si shpenzim i zbritshëm për efekt të tatim-fitimit të kompanisë. Kjo krijon një situatë "win-win": punonjësi merr një përfitim ekstra për pleqërinë, ndërsa kompania paguan më pak tatim-fitim.

3.3 Politikat e investimit dhe menaxhimi i riskut

Pyetja më e shpeshtë që lind është: "*Ku shkojnë paratë tona dhe sa të sigurta janë ato?*". Ndryshe nga bankat, fondet e pensionit nuk japin kredi, por i investojnë paratë në instrumente financiare me rrezik të ulët dhe afatgjatë.

3.3.1 Diversifikimi i portofolit

Sipas rregulloreve të AMF-së në Shqipëri, fondet private nuk mund t'i investojnë të gjitha paratë në një vend të vetëm. Ato ndjekin parimin e **diversifikimit** për të minimizuar rrezikun:

- **Bonot dhe obligacionet e thesarit (shtetërore):** Pjesa dërrmuese e fondeve në Shqipëri investohet këtu. Konsiderohen investimet më të sigurta sepse garantohen nga shteti.
- **Obligacionet e korporatave:** Investime në kompani të mëdha dhe të qëndrueshme që ofrojnë interes më të lartë se shteti.
- **Depozitat bankare:** Për të mbajtur një nivel likuiditeti (para të gatshme).

3.3.2 Strategjia sipas moshës (Lifecycle Investing)

Një aspekt i avancuar i menaxhimit të fondeve është përshtatja e investimit me moshën e anëtarit:

- **Për të rinjtë:** Fondi mund të investojë në instrumente pak më agresive për të maksimizuar fitimin, pasi ka kohë të rikuperohet nga luhajat e tregut.
- **Për ata pranë pensionit:** Fondi i zhvendos paratë në investime jashtëzakonisht konservatore (si Bonot e Thesarit), për të siguruar që shuma e grumbulluar gjatë jetës të mos preket nga asnjë rënie e mundshme e tregjeve financiare.

3.4 Skenarët e përfitimit: një analizë praktike

Për të kuptuar vlerën reale të një pensioni privat, është e domosdoshme të kryhen simulime bazuar në kohëzgjatjen e kursimit dhe normën e kthimit nga investimi. Në ndryshim nga sistemi shtetëror ku përfitimi është i paracaktuar nga ligji, në sistemin privat përfitimi është në përpjesëtim të drejtë me **disiplinën financiare**.

3.4.1 Skenari i kursimit afatgjatë (Rasti i një të riu 25-vjeçar)

Supozojmë se një individ fillon punën në moshën 25-vjeçare dhe vendos të kursejë një shumë modeste prej **5,000 lekësh në muaj** deri në moshën 65-vjeçare (40 vite kursim).

- **Kontributi total ndër vite:** 2,400,000 lekë.
- **Me një normë kthimi mesatare 5% (vjetore):** Për shkak të interesit të përbërë, shuma fundore në llogarinë e tij do të jetë përafërsisht **7,600,000 lekë**.
- **Rezultati:** Fitimi nga investimi është mbi 200% e shumës së kursyer. Ky individ mund të zgjedhë të marrë një pension mujor shtesë prej rreth **40,000 lekësh** për 20 vite rresht, krahas pensionit të shtetit.

3.4.2 Skenari i kursimit të vonuar (Rasti i një 45-vjeçari)

Nëse një individ fillon të kursejë të njëjtën shumë (5,000 lekë) por në moshën 45-vjeçare, ai ka vetëm 20 vite kohë deri në pension.

- **Kontributi total:** 1,200,000 lekë.
- **Me të njëjtën normë kthimi 5%:** Shuma fundore do të jetë rreth **2,050,000 lekë**.
- **Rezultati:** Ndonëse ka kursyer gjysmën e kohës së skenarit të parë, shuma fundore është gati 4 herë më e vogël. Kjo vërteton se në pensionet private, **koha vlen më shumë se shuma e parave**.

Tabela 3: Skenarët e Përfitimit: Analizë Praktike

Karakteristika	Skenari A (25 vjeç)	Skenari B (45 vjeç)
Kontributi mujor	5,000 Lekë	5,000 Lekë
Vite kursimi	40 Vite	20 Vite
Totali i investuar	2,400,000 Lekë	1,200,000 Lekë
Vlera fundore (me 5% interes)	~7,630,000 Lekë	~2,055,000 Lekë

Burimi: Autorët , 2026

3.5 Barrierat dhe rreziqet e sistemit privat persional në Shqipëri

Përtej përfitimeve financiare të lartpërmendura, qëndrueshmëria e pensioneve private në Shqipëri kushtëzohet nga një sërë faktorësh socio-ekonomikë. Ky nënseksion merr në analizë vështirësitë operative dhe rreziqet e tregut, të cilat mund të ndikojnë në performancën e fondeve dhe në nivelin e besimit të qytetarëve te ky mekanizëm kursimi."

- a. **Kultura e ulët financiare:** Shumë qytetarë shqiptarë ende nuk e kuptojnë dallimin midis një depozite bankare dhe një fondi pensioni. Mungesa e besimit te institucionet private (pasojë e krizave të viteve '97) mbetet një barrierë psikologjike.
- b. **Fuqia e ulët blerëse:** Me një pagë minimale prej 40,000 lekësh, shumë punonjës e kanë të pamundur të ndajnë një shumë mujore për pension privat, pasi të gjitha të ardhurat shkojnë për konsum bazë.
- c. **Rreziku i tregut:** Edhe pse fondet investojnë në instrumente të sigurta, nuk ka asnjëherë një garanci 100% për normën e fitimit. Nëse ekonomia globale kalon një krizë të gjatë, kthimi nga investimi mund të ulet, duke ndikuar në vlerën fundore të pensionit.
- d. **Kostot e administrimit:** Kompanitë private aplikojnë komisione për menaxhimin e fondit (zakonisht deri në 3% të aseteve në vit). Këto kosto duhet të jenë sa më të ulëta që të mos "hanë" fitimin e anëtarëve.

3.6 Pasqyra e tregut të pensioneve private në shqipëri

Tregu i pensioneve vullnetare në Shqipëri ka pësuar një rritje progresive vitet e fundit, ndonëse mbetet ende në hapat e parë krahasuar me vendet e Bashkimit Evropian. Sipas raporteve zyrtare të

AMF-së, asetet e fondeve të pensionit vullnetar kanë kaluar shifrën e 5.5 miliardë lekëve (rreth 55 milionë euro), me një numër anëtarësh që i kalon 38,000 individë.

Më poshtë janë institucionet kryesore që operojnë në vend:

✓ **SIGAL UNIQA Group Austria (Fondi i pensionit SIGAL)**

Si një nga pionierët e këtij tregu, Sigal zë pjesën më të madhe të tregut në Shqipëri.

- Strategjia: Ky fond fokusohet kryesisht në investime konservatore me rrezik të ulët, si Bonot e Thesarit të Qeverisë Shqiptare.
- Shtirja: Ka një bazë të gjerë anëtarësh, ku përfshihen si individë ashtu edhe skema profesionale (kompani që paguajnë për punonjësit e tyre).

✓ **Raiffeisen Pensions (Shoqëria Administruese Raiffeisen)**

Ky institucion sjell ekspertizën e grupit ndërkombëtar Raiffeisen, duke u fokusuar te siguria e lartë institucionale.

- Karakteristikat: Fondi i tyre vlerësohet për transparencën dhe raportimin e detajuar drejt anëtarëve.
- Portofoli: Pjesa dërrmuese e asetëve investohet në obligacione, duke siguruar një kthim të qëndrueshëm nga investimi gjatë dekadës së fundit.

✓ **AlbSig Pension**

Kjo është një tjetër kompani e rëndësishme vendase që ka treguar rritje të shpejtë, duke ofruar paketa fleksibël për personat e vetëpunësuar dhe profesionistët e lirë

3.7 Analiza e portofolit të investimeve të këtyre institucioneve

Për të kuptuar stabilitetin e këtyre institucioneve, duhet parë se ku i mbajnë ato paratë e anëtarëve. Struktura e investimeve për fondet private në Shqipëri është mjaft e standardizuar për shkak të rregullave të forta të AMF-së:

- Titujt e shtetit (bonot dhe obligacionet): Përbëjnë rreth 90-95% të investimeve. Kjo do të thotë se siguria e pensioneve private në Shqipëri është pothuajse e barabartë me sigurinë e borxhit shtetëror.
- Depozitat dhe Cash: Përdoren vetëm për likuiditet të menjëhershëm (për të paguar anëtarët që dalin në pension).

- Kthimi nga investimi: Historikisht, këto institucione kanë ofruar një normë fitimi mesatare prej 3.5% deri në 5% në vit, që është dukshëm më lart se interesat e llogarive rrjedhëse apo depozitave afatshkurtra bankare.

4. Analizë krahasuese dhe perspektiva e integritit të sistemeve pensionale

4.1 Krahasimi i tipareve strukturore të pensioneve publike me pensionet private

Për të kuptuar ndryshimet thelbësore midis dy alternativave, duhet të analizojmë elementet teknike që përcaktojnë sigurinë dhe vlerën e pensionit në secilin sistem.

Tabela 4. Krahasimi i tipareve strukturore: pension publik krahasuar me atë privat

Karakteristika	Sistemi publik (Shtylla I)	Sistemi privat (Shtylla III)
Baza ligjore	Detyrim ligjor / Sigurim social	Kontratë vullnetare / Investim
Parimi i funksionimit	Solidaritet (Pay-As-You-Go)	Kapitalizim individual
Pronësia e fondit	Kolektive (Shteti menaxhon fondin)	Individuale (Llogari personale)
Llogaritja e përfitimit	Formulë bazuar në vite pune dhe pagë	Kontributet + Fitimi nga investimi
Trashëgimia	Vetëm në kushte strikte familjare	100% e trashëgueshme te pasardhësit
Rreziku kryesor	Rreziku demografik (Plakja)	Rreziku i tregut (luhatjet)
Indeksi	Me vendim qeverie (inflacioni)	Varet nga performanca e portofolit

Burimi: Autorët, 2026

4.2 Analiza e alternativave: Cila është zgjedhja më e mirë?

Me qëllim ofrimin e një perspektive sa më praktike, në vijim do të trajtohen dy modele të ndryshme të planifikimit të pensionit në kontekstin shqiptar. Analiza do të fokusohet në vlerësimin e raporteve kosto-përfitim për secilën alternativë, duke analizuar se si zgjedhja e individit ndikohet nga faktorë si siguria e investimit, përfitimet tatimore dhe qëndrueshmëria afatgjatë e të ardhurave.

Në mjedisin aktual ekonomik të Shqipërisë, individët përballen me një vendimmarrje që do të përcaktojë cilësinë e jetës së tyre për 20 apo 30 vite pas përfundimit të karrierës. Më poshtë detajohen dy alternativat kryesore, duke analizuar implikimet financiare të secilës.

4.2.1 Alternativa a: Mbështetja ekskluzive të sistemi shtetëror (Shtylla I)

Kjo alternativë përfaqëson modelin tradicional ku individi i beson tërësisht shtetit për sigurimin e të ardhurave në pleqëri.

- **Garancia institucionale:** Avantazhi kryesor është siguria që ofron "arka e shtetit". Për sa kohë ekziston shteti shqiptar, ekziston një detyrim kushtetues për të paguar pensionet. Ky sistem është i imunizuar nga falimentimi i tregjeve financiare.
- **Limitimi (Tavani i pensionit):** Problemi kritik këtu është se pensioni nuk rritet në përpjesëtim të drejtë me suksesin e individit. Për shkak të pagës maksimale kontributive, një individ që fiton 200,000 lekë do të marrë pothuajse të njëjtin pension si një që fiton 130,000 lekë. Kjo krijon një "ndëshkim" për profesionistët e nivelit të lartë.
- **Rreziku politik dhe legjislativ:** Individi nuk ka kontroll mbi moshën e daljes në pension apo mbi masën e indeksimit. Nëse qeveritë e ardhshme vendosin ta rrisin moshën në 70 vjeç për shkak të krizës demografike, individi në këtë alternativë është thjesht një "pagues pasiv" i pasojave.

4.2.2 Alternativa B: Modeli i kombinuar (shtetëror + pension privat)

Ky skenar përfaqëson një qasje proaktive, ku individi përdor shtetin si "rrejtë sigurie" dhe fondin privat si "motor rritjeje".

- **Diversifikimi i rreziqeve:** Kjo është zgjedhja më e matur sipas teorisë moderne të portofolit. Individi nuk i vendos të gjitha "vezët në një shportë". Nëse shteti përballlet me krizë demografike, llogaria private e individit mbetet e paprekur pasi ajo bazohet në kursime reale dhe jo në premtime politike.

- **Optimizimi i të ardhurave neto (Kursimi fiskal):** Siç u analizua, kjo alternativë është më e lira për individin. Përmes zbritjes së TAP-it, shteti praktikisht "bashkë-financon" pensionin tënd privat. Për çdo 1,000 lekë që investon, një pjesë është para që do t'ia jepje shtetit si taksë, por që tani mbetet në llogarinë tënde.
- **Fleksibiliteti dhe trashëgimia:** Ndryshe nga Alternativa A, ku në rast vdekjeje kontributet mbeten në arkat e shtetit (nëse nuk plotësohen kushtet për pension familjar), në Alternativën B, çdo lek i grumbulluar në fondin privat u kalon trashëgimtarëve. Ky element e kthen pensionin nga një "shpenzim" në një "trashëgimi familjare".

4.2.3 Krahasimi përmes "Indeksit të zëvendësimit"

Një mjet matës për të dyja alternativat është **Indeksi i zëvendësimit** (raporti pension/pagë fundore).

- Në **Alternativën A**, ky indeks tenton të bjerë poshtë **35%** për pagat mbi mesataren, duke rrezikuar një rënie të menjëhershme të nivelit të jetesës.
- Në **Alternativën B**, përmes kursimit privat, individit mund të synojë një indeks zëvendësimi prej **60-75%**, duke siguruar që tranzicioni nga puna në pension të mos shoqërohet me goditje ekonomike.

4.3 Perspektiva e të ardhmes dhe rekomandime strategjike

Duke u nisur nga analiza e mësipërme, e ardhmja e pensioneve në Shqipëri kërkon një qasje proaktive dhe reforma që përshtaten me ndryshimet e tregut të punës. Më poshtë renditen disa rekomandime dhe trende që do të diktojnë dekadat e ardhshme:

- **Rishikimi i stimujve tatimorë:** Ndonëse Shqipëria ofron lehtësi për shtyllën e tretë, nevojitet një rritje e tavanit të pataksueshëm për kontributet vullnetare. Kjo do të nxisë shtresën e mesme të investojë më shumë, duke u siguruar që mjetet financiare të qëndrojnë brenda ekonomisë shqiptare në formë investimesh.
- **Implementimi i "Auto-enrollment" (Anëtarësimi automatik):** Një rekomandim i tjetër është ndjekja e modelit Britanik, ku çdo punonjës regjistrohet automatikisht në një fond pensioni privat nga punëdhënësi, me mundësinë për t'u çregjistruar nëse dëshiron. Kjo rrit masivisht numrin e kursimtarëve pa pasur nevojë për fushata agresive

marketingu.

- **Përshtatja me "Gig Economy":** Shteti duhet të krijojë skema specifike për punonjësit digjitalë (freelancers) të cilët shpesh mbeten jashtë mbrojtjes sociale. Krijimi i platformave ku këta individë mund të kontribuojnë me vlera fleksibël në varësi të të ardhurave mujore është jetik.

Përfundime dhe rekomandime

Ky punim kërkimor mori në analizë dy shtyllat kryesore të sistemit të pensioneve në Shqipëri: publike dhe atë private. Pas një analize të detajuar, rreziqeve demografike dhe avantazheve teknologjike, arrihet në këto konkluzione dhe sugjerime përfundimtare:

1. **Superioriteti i kapitalizimit individual:** Sistemi i pensioneve private ofron përfitime që shteti nuk mund t'i premtojë: pronësinë mbi fondin dhe trashëgiminë (nëse anëtari ndërron jetë përpara ose gjatë kohës që përfiton pensionin, shuma e mbetur në llogari u kalon trashëgimtarëve ligjorë). Ndryshe nga kontributet shtetërore që shkojnë në një "arkë të përbashkët", kontributet private janë asete individuale që investohen dhe rriten përmes interesit të përbërë.

2. **Digjitalizimi si garanci transparence:** Digjitalizimi i sistemeve (përmes e-Albania dhe aplikacioneve Fintech) ka luajtur një rol kyç në rritjen e besimit të sistemit. Mundësia për të monitoruar kontributet në kohë reale ka reduktuar informalitetin dhe i ka dhënë qytetarit fuqinë për të qenë kontrollues i pasurisë së tij. Teknologjia Blockchain mbetet një perspektivë premtuese për të blinduar sigurinë e të dhënave kontributive për dekadat e ardhshme.

3. **Nevoja urgjente për diversifikim (pensione publike dhe private).** Analiza vërtetoi se mbështetja ekskluzive të Sistemi Shtetëror (Shtylla I) mbart rreziqe të larta për brezat e ardhshëm. Për shkak të plakjes së popullsisë dhe emigracionit të forcës aktive punëtore, raporti kontribues/pensionist po përkeqësohet. Përfundimi kryesor është se pensioni shtetëror duhet të shihet si një garanti bazë (dysHEME), ndërsa pensioni privat si mjeti i domosdoshëm për të garantuar mirëqenien (tavanin).

4. **Krijimi i një qendre kombëtare për edukimin financiar** Një rekomandim vizionar është krijimi i një platforme ndër-institucionale (Banka e Shqipërisë, AMF, Ministria e Financave) që ofron këshillim falas për qytetarët. Kjo do të ndihmonte në thyerjen e miteve se

"pensionet private janë vetëm për të pasurit" dhe do të krijonte një brez kursimtarësh më të ndërgjegjshëm.

Rekomandime për të ardhmen

Implementimi i shtyllës II: Shqipëria duhet të konsiderojë kalimin drejt një sistemi ku një pjesë e kontributeve të detyrueshme të kalojë në llogari private të kapitalizuara.

Edukimi financiar: Nevojitet një fushatë kombëtare për të edukuar të rinjtë mbi rëndësinë e kursimit të hershëm. Investimi në pension që në moshën 20-vjeçare kërkon sforcim minimal, por jep përfitime maksimale.

Stimujt tatimorë: Shteti duhet të zgjerojë lehtësitë fiskale për punëdhënësit që paguajnë pensione private për stafin e tyre, duke e kthyer këtë në një standard të tregut të punës.

Referencat

- a) Altax. (2025). *Reforma e sistemit të pensioneve në Shqipëri: Hapat për një të ardhme më të sigurt*. <https://altax.al/reforma-e-sistemit-te-pensioneve-ne-shqiperi-hapat-per-nje-te-ardhme-me-te-sigurt/>
- b) Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. (2022). *Raporti vjetor mbi tregun e pensioneve private në Shqipëri*. <https://www.amf.gov.al>
- c) Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. (2024). *Statistikat e tregut të pensioneve private vullnetare*. <https://www.amf.gov.al>
- d) Instituti i Sigurimeve Shoqërore. (2023). *Sistemi i sigurimeve shoqërore në Shqipëri*. <https://www.isshe.gov.al>
- e) Instituti i Sigurimeve Shoqërore. (2024). *Raporti vjetor statistikor 2023–2024*. <https://www.isshe.gov.al>
- f) Khozrevanidze, M. (2022). *The impact of accumulative pension policy on welfare of individuals*. <https://arxiv.org/abs/2202.12721>
- g) Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. (1993). *Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993, për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë* (i përditësuar). <https://www.qbz.gov.al>
- h) Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. (2009). *Ligji nr. 10197, datë 10.12.2009, për fondet e pensionit vullnetar*. <https://www.qbz.gov.al>
- i) OECD. (2021). *Pensions at a glance 2021: OECD and G20 indicators*. OECD Publishing. <https://doi.org/10.1787/ca401ebd-en>
- j) Organisation for Economic Co-operation and Development. (2021). *Pensions at a glance 2021: OECD and G20 indicators*. OECD Publishing. <https://www.oecd.org>

- k) Polifakt. (2026). *Sfida fiskale dhe strukturore për reformimin e skemës së pensioneve në 2026*. <https://polifakt.al/sfida-fiskale-dhe-strukturore-per-reformen-e-pensioneve-2026>
- l) Xhepa, S. (2025). *Reforma e pensioneve dhe sfidat strukturore në Shqipëri*. <https://mapo.al/shqiperi/ekonomi/reforma-e-pensioneve-a-eshte-shqiperia-e-vonuar-analiza-nga-lib-i7214720>
- m) World Bank. (2019). *The World Bank pension conceptual framework*. World Bank Publications.
- n) World Bank. (2022). *Pension systems in transition economies*. World Bank Publications. <https://www.worldbank.org>
- o) World Bank. (2025). *Albania Public Finance Review: Enhancing Fiscal Sustainability for Inclusive Growth*. <https://www.worldbank.org/en/country/albania/publication/pfr-2025>